



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

DATE _____ 2018

TERMA REFERENCE

PËR MBIKQYRJE PUNIMESH NËOBJEKTIN;
**“Rehabilitimi i segmentit rrugor Mbikalimi i pallatit me shigjeta-Rrethrotullimi
Shqiponja”Loti 1**

Vlera 18 451 638 lekë (me tvsh)

Hartoi: Grupi i Punës ngritur me UB Nr,109 datë26.07.2018

I - INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Me fondet nga buxheti ishtetit përvitin 2018e në vazhdim është parashikuar të kryhet mbikqyrja e punimeve në objektin: **“Rehabilitimi i segmentit rrugor Mbikalimi i pallatit me shigjeta-Rrethrotullimi Shqiponja ”Loti 1**

Për këtë qëllim i kërkohet mbikqyrësit të punimeve të kësaj Kontrate, të kryejë mbikqyrjen e këtij objekti me fondin limit të mbikqyrjes së llogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 354, datë 11.05.2016 *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”*

II - PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Loti 1 km (0÷ 0+760)km (Nyja tek Sheshi Shqiponja + mbikalimi i rrugeve dytesore)

Nyje e konceptuar me tre nivele, lidh rrugen Dritan Hoxha me rrugen Teodor Keko dhe vazhdimet e tyre. Unaza në sheshin Shqiponja të vazhdojë pa ndërprerje me mbikalim dhe lidhet me rrethrotullimin e Sheshit Shqiponja nëpërmjet korsive anësore. Rrethrotullimi përmirëson mjaft qarkullimin dhe zgjidh opsionet hyrje dalje në unazë dhe në rrugën “Dritan Hoxha”. Për të bërë kalimin e automjeteve të rruges së shërbimit nga njëra anë e rruges kryesore në anën tjetër janë projektuar dy mbikalime rreth 150m larg rrethrotullimit. Rruga “Dritan Hoxha” ka kalim të drejtëpërdrejtë me nenkalim. Për efekte funksionale të nyjes futje të rrugeve anësore në rrethqarkullim bëhet vetëm me një drejtim dhe shkëmbimi i rrymave të trafikut të rruges sekondare bëhet me anë të një mbikalimi që zhvillohet përpara fillimit të mbikalimit të rruges kryesore.

Mbikalimi sekondar është dhënë me dy zgjidhje me përparësi dhe semafor të cilat do të vendosen nga enti menaxhues i rruges. Rrezet e kthimit të mbikalimit sekondar janë bërë mbi rrezet minimale.

Mbikalimi kryesor është konceptuar : pjesa qendrore ure me 3 hapësirë me 32.4m me gjatësi aksiale 33.85m, dy kampata anësore dhe 33.7m, kampata qendrore dhe dy balle. Panduset rakorduese janë mbushje me tokë të armuar të veshura me mure betoni për veshjen arktektonike.

Nenkalimi në sheshin Shqiponja i cili lidh rrugën “Dritan Hoxha” me unazën për në Durrës është projektuar në strukturë box me gjatësi të brendshme 10.3m përkatesisht me dy korsitë 3.5m + bankinë 0.5 dhe trotuar 0.65m dhe lartësi të brendshme 5m.

Nenkalimi i kembësoreve janë struktura box (3x3)m bëhet me anë të nenkalimit me ashensor dhe panduse të pjerrëta brenda rrethqarkullimit do të realizohet një shesh urban i hapur që i jep dritë dhe ajër nenkalimeve dhe formon ambient vizual të mbrojtur, larg trafikut dhe peisazhit tipik industrial që formojnë mbikalimet.

Rrethqarkullimi është në kuotën e sistemeve dhe ka rreze të brendshme të korsive R=35.5m dhe të jashtme R=46m.

Segmenti i unazës ka seksion tip (2x3.75korsi+1x3korsi emergjence +0.7m bankinë nga ana e brendshme). Rruget urbane janë projektuar me dy sense levizjeje dhe shtrihen paralel me unazën në të dy anët e saj. Gjithashtu janë parashikuar 2korsi bicikletash me 2.5 m gjatësi, trotuar 2,5m si dhe një brez të gjelbër 1m

Rruget sekondare (urbane) janë të kategorisë E

Për të gjitha rruget sekondare që lidhen me rruget e shërbimit është dhënë si zgjidhje një tip nyje e trajtuar me ishuj trafiku dhe semafore paralajmërues.

Të gjitha nyjet janë të pajisura me sinjalistike të nevojshme horizontale dhe vertikale.

III- OBJEKTIVI KRYESOR

Mbikqyrësi i punimeve të zbatimit të punimeve për objektin ka për qëllim të kontrollojë dhe të ndjeke mbarëvajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike si dhe destinacionin e objektit duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve të këtij objekti dhe anën ekonomike të këtij objekti (vlefë e kontratës).

IV- DETYRAT, PËRGJEGJËSITE DHE TË DREJTAT E MBIKQYRËSIT

Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të objektit :“ **Rehabilitimi I segmentit rrugor Mbikalimi i pallatit me shigjeta- Rrethrotullimi Shqiponja** ”Loti Mbikqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet:

- Të mbikqyrë Kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe të kryejë të gjitha detyrimet e besuara atij sipas Kontratës së nënshkruar dhe sipas Ligjit Nr. 8402 datë 10.09.1998, te ndryshuar ,UKM Nr.3 dt.15-02 2001, UKM Nr.1 dt. 22.02.2005, UKM Nr 2 dt.13.5.2005 dhe të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim.
- Të njihet në detaj me projekt zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit, të hartoj programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilësisë së punimeve në bazë të standardeve të përcaktuara me ligj.
- Të paraqesë pranë ARSH-sëstafin e tij mbikëqyrës në përbërje të së cilit duhet të ketë:

1. **Drejtuesin e projektit** që duhet të jetë inxhinier ndërtimi, me eksperiencë pune në mbikëqyrje i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, certifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, korespondencën me ARrSh.

2. **Mbikqyrësin e materialeve** që duhet të jetë inxhinier ndërtimi me eksperiencë pune në këtë fushë i cili miraton materialet dhe cilësinë e tyre dhe ndjek e miraton cilësinë e punimeve.

3. **Mbikqyrësin për punimet topografike** që duhet të jetë inxhinier topograf me eksperiencë pune i cili kontrollon dhe miraton volumet, piketimet dhe kuotëzimin e objektit.

4. **Mbikqyrësin (gjeolog), duhet të jetë inxhinier gjeolog** me eksperiencë pune i cili kontrollon punimet gjatë gërmimit .

5. **Mbikqyrësin për punimet e sinjalistikës dhe sigurisë rrugore** që duhet të jetë inxhinier me license me eksperiencë pune në këtë fushë i cili miraton materialet dhe cilësinë e tyre ndjek e miraton cilësinë e punimeve.

6. **Mbikqyrësin për punimet e rrjetit të ujësjes** që duhet të jetë inxhinier hidroteknik me license dhe me eksperiencë pune në këtë fushë.

7. **Mbikqyrësin për punimet e gjelberimit** që duhet të jetë inxhinier me license dhe me eksperiencë pune në këtë fushë.

8. **Mbikqyrësin per punimet elektrike** që duhet të jetë inxhinier me license dhe me eksperiencë pune në këtë fushë.

9. **Mbikqyrësin për verat e artit** që duhet të jetë inxhinier konstruktor me eksperiencë pune në projektim dhe në zbatim me licensë për këtë qëllim.

Shënim: Në bazë të volumit të punimeve dhe vleftës së kontratës drejtuesi i punimeve duhet të jetë rezident në objekt dhe stafi tjetër mbikëqyrës mund të jetë rezident cdo dite në objekt ose me kohë të pjesshme në funksion të specifikave të punës.

- Mbikqyrësi i punimeve dhe stafi i tij kontraktin me ARrSh-në, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin dhe probleme të tjera, etj.
- Mbikqyrësi vihet në dijeni nga ARrSh-ja për nënkontraktorët e mundshëm që zgjedh sipërmarrësi në përputhje me kontratën e nënshkruardhe miratuar nga ana e tij (investitori).
- Mbikëqyrësi në fillim të punimeve në objekt merr kontakt me organet qeverisëse në juridiksionin e të cilit ndodhet zona ku kryhet ky objekt dhe informon për personat kryesor, përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti në përputhje me nenin 9, të ligjit Nr.8402, dt 10.09.1998.
- Mbikqyrësi në fillimin e punimeve së bashku me kontraktorin duhet të bëjë një inspektim të gjëndjes së rrugës ekzistuese duke bërë inventarin e plotë të të gjithë aseteve rrugore të cilat do hiqen dhe do magazinohen si dhe tjerat që do prishen.
- Mbikqyrësi i punimeve në fillimin epunës do të marrë kontakt dhe me kompanitë e mirmbajtjes të kontraktuara nga ARSSH apo entet tjera publike dhe të ndajë detyrat gjatë kohës së zhvillimit të punimeve në objektin e marrë në dorëzim.

Mbikqyrësi ka për detyrë:

- Të bëjë verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të licencave, të autorizimeve dhe të lejeve, të cilat sipas dispozitave në fuqi duhet të merren para fillimit të punimeve.
- Të bëjë verifikimin e sheshit të ndërtimit nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet.
- Të njihet mirë me kontratën e sipërmarrësit dhe të gjitha akteve administrative që lidhen me të si dhe të njohë të gjitha ndryshimet e mundshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.
- Të kontrollojë vendosjen e tabelës së identifikimit të objektit më këto të dhëna:

Emertimi i objektit: "Rehabilitimi I segmentit rrugor Mbikalimi i pallatit me shigjeta-Rrethrotullimi Shqiponja "Loti 1

Investitori	Autoriteti Rrugor Shqiptar
Projektuesi	AVE Consulting shpk
Sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik	_____
Mbikqyrësi	_____
Afati i ndërtimit të objektit	_____
Data e fillimit të punimeve	_____
Data e mbarimit të punimeve	_____
Vlera e objektit	_____

Mbikqyrësi menjëherë mbas lidhjes së Kontratës duhet :

- Të marrë masat e duhura për sigurinë e objektit duke kontrolluar vendosjen në objekt të tabetave përkatëse sinjalizuese, treguese e të sigurisë, shiritave, fenerëve etj.
- Mbas verifikimit të dokumentacionit duhet të dorëzojë pranë ARrSh-së të gjithë

dokumentacionin si dhe shkresën për fillimin e punimeve ku përfshihen:

- Stafi i Sipërmarrësit
 - Makineritë që do përdoren për ndërtimin e objektit.
 - Menaxhimin e trafikut gjatë fillimit dhe vazhdimin e punimeve
- Para fillimit të punimeve verifikon të gjitha pajisjet dhe makineritë e sipërmarrësit, për të parë nëse ato i përgjigjen kushteve të kontratës së nënshkruar.
 - Të kontrollojë projektin e zbatimit të marrë në dorëzim nga Investitori dhe ta krahasojë atë me preventivin e punimeve dhe mbas rikonjicionit topografik në vend, të relatojë shmangjet apo mosperputhjet në mes preventivit projektit dhe terrenit.
 - Të kontrollojë zbatimin e projektit duke u bazuar në projekt zbatimin dhe specifikimet teknike dhe të propozojë modifikimet, plotësimet dhe mospërputhjet nëse ka dhe t'i rekomandojë ARrSh-së zgjidhjet konkrete.
 - Të kontrollojë dhe të miratojë planin e menaxhimit të trafikut në pjeset ku do nderohen në akset ekzistuese dhe të ndjeko me rigozitet zbatimin korrekt të tij.
 - Të ndjek në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacioneve që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta duke dhënë udhëzime porosi e urdhëra për zbatimin me përpikmëri e në kohë të projektit, të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit, të dispozitave përkatëse të kontratave.
 - Të kontrollojë në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme piketimin e objektit.
 - Të kontrollojë cdo material që vendoset në vepër, mënyrën e vendosjes së tij dhe cilësinë e tij.
 - Për cdo punim të maskuar të bëjë fotografimin ose regjistrim e tij dhe të mbaj proces-verbal të firmosur prej tij dhe sipërmarrësit.
 - Në cdo fund ditë pune të kontrollojë ditarin e punimeve dhe të firmos atë.
 - Të kontrollojë librin e masave të cilin vërteton volumin e punimeve dhe ta miratojë atë.
 - Të kontrollojë certifikatat e cilësisë së materialeve dhe të jap miratimin për vendosjen në objekt të tyre.
 - Gjatë zbatimit të projektit, i jep instruksione me shkrim sipërmarrësit. sa herë që e shih të nevojshme. dhe sipërmarrësi është i detyruar t'i zbatojë ato. Ky i fundit ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me instruksionet dhe urdhërat e marrë.
 - Për cdo rast, që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në Projektin dhe Preventivin e parashikuar, Mbikëqyrësi i Punimeve duhet t'i paraqesë ARrSh -së një relacion të plotë teknik (shoqeruar me skicat përkatëse) ku argumentohet ndryshimi. Ndryshimi në objekt (zbatimin e punimeve) do të bëhet vetëm pas miratimit nga ARrSh -ja.
 - Në cdo fund muaji mbikëqyrësi ka për detyrë të paraqesë pranë ARrSh -së raport mujor të punimeve. Në këtë raport duhet të jepet një tablo e qartë e avancimit të punimeve dhe të pagesave të kryera. Realizimi i punimeve në vlefte dhe përqindje, afati kohor realizimi i financimit.

Raporti Mujor do të ketë këtë përmbajtje:

- Hyrje
- Informacion i përgjithshme

Të përgjithshme

Qëllimi i punimeve

Mbikqyrja e punimeve ndërtimore

- Personeli i siguruar nga Mbikqyrësi

Stafi i nevojshëm në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve .

Stafi aktual

Kohëqendrimi në objekt përsecilin.

- Raportimi
- Kohëzgjatja e shërbimit të Mbikqyrjes

Përshkrimi i Projektit

Shtresat Rrugore

Veprat e Artit etj.

Organizimi i Sipërmarrësit

Sipërmarrësi

Stafi prezent

Mjete dhe makineri

Kohëqendrimi në objekt

Progresi Mujor

Përshkrim të Punimeve që janë kryer gjatë muajit (sipas zërave dhe piketave)

Fotografi të proceseve të punimeve të kryera

Fotografi të punimeve të maskuara për çdo punim të padukshëm.

Grafiku i ecurisë së punimeve

- a - Të aprovuara
- b - Të kryera

Volumet Progressive të Punimeve Mujore

- a - Punimet e aprovuara
- b - Çertifikatat e cilësisë dhe Provat Laboratorike
- c - Libreza e Masave
- d - Punimet e kryera por të pa aprovuara
- e - Situacionet mujore
- f - Matjet topografike

Korrespondenca

- a - Proces-Verbale
- b - Urdhëra, Udhezime, Njoftime
- c - Ndryshime në Projekt dhe Preventiv nese ka (te aprovuara nga ARrSh-ja)

Moti (kalendarik)

Problemet që kanë dale

- a - Teknike
- b - Sociale

Konkluzione

Shenim :Raporti Mujor dhe dokumentat duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, në pesë kopje dhe tre kopje të dorëzohen në ARrSh pranë Drejtorisë Përkatese.

Raporti Mujor do t'i dorëzohet ARrSh-së brenda datës së caktuar në kontratë.

Konsulenti do të mbajë kontakte të vazhdueshme me ARrSh (Drejtorinë përkatëse) dhe do t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të saj.

Mbikqyrësi mban përgjegjësi të plotë ;

Në fillim të punimeve mbikqyrësi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e mëposhtëm :
Projektzbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori së bashku me specifikimet teknike
Dokumentacionin topografik dhe gjeologjor-inxhinierik të bazamentit ku do të kryhen punimet

Realizimin e punimeve të objektit sipas projektit kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifitimeve teknike

Saktësinë vërtetësinë e dokumenteve volumet dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.

Për realizimin pike për pikë të kontratës së nënshkruar midis Sipërmarësit dhe A.Rr.Sh-së e të gjitha fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit si dhe të kostos së objektit.

Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e mbikqyrësit.

Ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe korespondencën me Drejtorinë përkatëse pranë ARRSH, urdhërat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjithë fazave të zbatimit të punimeve.

Për dorëzimin e gjithë dokumentacionit që disponon në rast se gjatë zbatimit të kontratës kemi ndërrim të mbikqyrësit, i gjithë dokumentacioni dorëzohet me proces verbal ku shënohen dhe shkaqet e këtij ndërrimi.

Mbikqyrësi ka të drejtë :

◆ Të kërkojë largimin nga puna të drejtuesit të kantierit, të stafit tjetër teknik të mbikqyrësit në objekt, ose të punëtorëve të vecantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë.

◆ Të mos pranojë drejtues teknik, staf tjetër teknik mbështetës sipas këtyre Termave, manovrator, punëtor n.q.s këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar.

◆ Të pezullojë punimet kur sheh se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar punimet dhe trafikun.

◆ Të mos lejoj vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe të zëvendësojë ato me materiale të tjera nga sipërmarësi me shpenzimet e tij.

◆ Të kërkojë certifikatat e cilësisë së pajisjeve që kryejnë testet e materialeve.

◆ Të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarësit.

◆ Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në vepër dokumentacionet teknike për të siguruar një ecuri punimesh të sigurt dhe cilësore.

◆ Të mos lejojë përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme n.q.s ato janë jashtë kushteve teknike.

◆ Në rast se materialet dhe pajisjet e perdorura nuk miratohen nga mbikqyrësi këto duhet të dokumentohen me proces-verbalet e analizave të provave së bashku me aktin teknik, ku të argumentohen shmangiet e palejuara referuar standarteve të përcaktuara në specififikimet teknike të projekt zbatimit.

◆ Kur Mbikqyrësi i Punimeve mendon se ka dëmtime në konstrukcion kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikqyrësit, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarësit. Në rast të kundërt, sipërmarësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve në rrugë kontraktuale.

◆ Mbikqyrësi i Punimeve urdhëron Sipërmarësin të prishë dhe të ribejë me shpenzimet e tij, punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në Projekt dhe Specifikimet Teknike.

◆ Mbikqyrësi i punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet, për ekzekutim teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, për cdo rast me miratimin e ARrSh-së për aq kohë sa ai e konsideron të arsyeshme. Në këtë rast sipas shkakut, Mbikqyrësi së bashku me ARrSh-në dhe sipërmarësin përcaktojnë zgjatjen ose jo të afatit dhe ndryshimin e shpenzimeve.

◆ Të kontrollojë dhe autorizojë përdorimin e fondit rezervë të preventivuar sipas legjislacionit për këtë qëllim dhe i raporton periodikisht ARrSh-së për gjendjen e tij.

◆ Për cdo ndryshim të mundshëm mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë.

Në përfundim të punimeve mbikëqyrësi:

- Merr me shkrim njoftimin për përfundimin e punimeve dhe vërteton në proces verbal datën e përfundimit të tyre sipas projektit, të ndryshimeve të urdhëruara e të kushteve të kontratës dhe brenda 30 ditëve merr prej sipërmarrësit dokumentacionin përkatës .
- Duke u mbështetur në Ligjin 8402 dt 10.09.1998 UKM Nr 2 datë 13.5.2005 dhe UKM Nr 3 datë 15.02.2001 dorëzon pranë ARrSh -së (Drejtorisë Perkatëse) te gjithë dokumentacionin përkatës për të cilin mban përgjegjësi të plotë në plotësimin , saktësinë, vërtëtesinë e tij.

Ky dokumentacion duhet të përmbajë :

- Proces verbal i dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
- Proces verbal për fillimin e punimeve.
- Kontraten e sipërmarrësit
- Kontratën e mbikëqyrjes
- Projekt organizimi i punimeve.
- Projektin
- Projektin e ndryshuar (nese ka) shoqëruar me korespondencën skicat përkatëse dhe miratimet e nevojshme.
- Preventivin fitues
- Preventivin e ndryshuar (nese ka zërat të rinj të punimeve negociimin e tyre).
- Grafiku i punimeve
- Specifikimet teknike
- Azhurnimi para fillimit të punimeve dhe piketimi.
- Dokumentacioni topografik dhe gjeologjor inxhinjorik për rrugën, veprat e artit (ura mbikalime, nenkalime etj).
- Dokumentacioni fotografik apo video regjistrime për punimet e padukshme.
- Proces-verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtusi teknik dhe mbikëqyrësi të shoqëruar me fotografi.
- Ditari i objektit ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdhëruara nga mbikëqyrësi.
- Libreza e masave.
- Shkresën embikëqyrësit për investitorin ku raporton përdorimin e fondit rezerve shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
- Proces verbal i përdorimit të fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi së bashku me miratimin e Investitorit.
- Preventivi i fondit rezervë të firmosur nga sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi
- Situacioni i fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi
- Certifikatat e cilësisë së materialeve.
- Miratimi i materialeve të përdorura nga kontraktori.
- Situacionet pjesore dhe atë përfundimtar.
- Regjistri i kontabilitetit.
- Deklarata teknike e sipërmarrësit e firmosur nga sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik.
- Njoftimi i sipërmarrësit për përfundimin e punimeve.
- Proces verbal i përfundimit të punimeve të firmosur nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi së bashku me matjet faktike të objektit të ndërtuar.
- Relacionin përfundimtar i mbikëqyrësit
- I gjithë dokumentacioni duhet të ketë miratimin e tij. Ky dokumentacion do të jetë në

3 (tre) kopje. Një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë grupit të kolaudimit që ngrihet me urdhër nga ARrSh -ja brenda 30 ditëve nga përfundimi i objektit. Të gjithë dokumentat që dorëzohen Grupit të Kolaudimit pranë ARrSh -së duhet të jenë origjinalë

Mbikëqyrësi i Punimeve merr pjesë në Kolaudimin e objektit dhe i përgjigjet Grupit të Kolaudimit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të objektit dhe nënshkruan aktin përkatës. Pas përfundimit të kolaudimit mbikëqyrësi i punimeve mbështetur në kontratën dhe nëdokumentacionin tjetër, përcakton vlerën përfundimtare të objektit e cila i bëhet e ditur sipërmarrësit dhe i jepet për të likuiduar ARrSh-së.

IV - KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT TË MBIKËQYRJES

Do të jetë për gjithë periudhën e zbatimit të punimeve.

V - TË DREJTAT E A.RR.SH-së.

ARrSh-ja ka të drejtë të kërkojë largimin e mbikëqyrësit kur verteton mangësi serioze në veprimtarinë tij si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara.
- Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet. Tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuar, tolerim të materialeve jashtë cilësisë së kërkuar, tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar, tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike.

Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, ARrSh-ja ka të drejtë të urdhërojë mbikëqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjëndjes. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundervajtje administrative, vendosen sanksione në bazë të neneve 15 dhe 16 të kreut III të ligjit Nr 8402 dt 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"

VI - MËNYRA E DHËNIES SË OFERTËS.

Oferta jepet në vleftë totale e zbrërthyer në shpenzime për muaj - njeri (sipas preventivit bashkëngjitur) dhe shpenzime të tjera të nevojshme për tu kryer.

VII - MËNYRA E PAGESËS.

Pagesa do të bëhet mujore në bazë të % së realizimit të punimeve të zbatimit e zbrërthyer sipas shpenzimeve muaj- njeri në zbatim të kushteve të pagesës në kontratë.

PREVENTIV
MBIKQYRJE PUNIMESH
**Objekti :“Rehabilitimi I segmentit rrugor Mbikalimi i pallatit me shigjeta-
Rrethrotullimi Shqiponja ”Loti 1**

Vlera e Kontratës _____ lekë(me TVSH)

Kodi	Emërtimi	Njësia	SHPENZIMET		
			Sasia	Çmimi	Vleftha
	Stafi				
1	Drejtor projekti	Staf - muaj	(100%)		
2	Inxhinier materiali	Staf - muaj	(100%)		
3	Inxhinier topograf	Staf - muaj	(100%)		
4	Inxhinier gjeolog	Staf - muaj	(70 %)		
5	Inxhinier per sigurine rrugore	Staf - muaj	(20 %)		
6	Inxhinier elektrik	Staf - muaj	(25%)		
7	Inxhinier mjedisi	Staf - muaj	(10%)		
8	Inxhinier konstruktor	Staf - muaj	(100 %)		
9	Inxhinier hidroteknik	Staf - muaj	(20%)		
	Shuma 1				
	Shpenzime				
	Shpenzime të ndryshme	Lump sum			
	Paisje , maeriale etj	Lump sum			
	Shuma 2				
TOTALI					

MBIKQYRËSI I PUNIMEVE

“ _____ ”